



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KUVENDI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 11, 12.2 shkronja d), nenit 17 shkronjat a) dhe s) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 154.2 të ligjit për procedurën e përgjithshme administrative nr.05/L-031, neneve 14, 15 paragrafi 2.4 dhe nenit 19 paragrafët 1.1) 1.19) të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/21 të datës 29 qershor 2018, Kuvendi i Komunës së Podujevës në mbledhjen e mbajtur më 28 qershor 2021, mori këtë;

### **V E N D I M**

#### **Neni 1**

Me këtë vendim pezullohet përkohësisht zbatimi i dispozitave: *neni 5 paragrafët 1.3; 2.3; dhe 4.4, neni 6 paragrafi 4, neni 7 paragrafi 2, neni 9 paragrafi 1.3, neni 12 paragrafi 2, neni 15 paragrafi 2.4; neni 16 paragrafi 2.3 dhe neni 17 paragrafi 2*, të Rregullores nr.prot.01-311/05-0007450/20 për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës të datës 31 janar 2020.

#### **Neni 2**

Kohëzgjatja e pezullimit sipas nenit 1 të këtij vendimi, respektivisht lejimi që dita e diel të jetë ditë pune për subjektet afariste/bizneset, bëhet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi deri më 30 shtator 2021.

#### **Neni 3**

Arsyeja e pezullimit të neneve të cekura, përkatësisht lejimi i punës edhe ditëve të diela për subjektet afariste/bizneset që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës, është ofrimi i mundësive për afarizëm dhe qarkullim të bizneseve me qëllim të ngritjes së tyre si pasoj e dëmeve të shkaktuara nga Pandemia Covid-19, furnizim dhe shërbime të rregullta për qytetarët në këtë periudhë verore kur pritet edhe ardhja e një numri të madh të bashkatdhetarëve për pushime në Kosovë.

#### **Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoritë e Komunës varësisht fushveprimtarisë dhe kompetencave përkatëse.

#### **Neni 5**

Vendimi hynë në fuqi 7 ditë pas publikimit në ueb faqe zyrtare të Komunës së Podujevës.

**Nr.prot.01-300/01-005183/21**  
**Podujevë,**  
**28 qershor 2021**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Fatmir Gashi**